REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 804/22 ; 807/22
Datë/Datum. 14.03.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 804/22 dhe 807/22

Paneli shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vjosa Gradinaj Mexhuani–Kryetare ,Vedat Poterqoi-Referues dhe Agon Ramadani Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik (GOE) "Pro&Co Group ShPK & Victoria Invest International ShPK" me seli në Graçanicë dhe ankesës së parashtruar nga GOE "Lika Trade ShPK dhe Lika Company ShPK" me seli në Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Për Mirëmbajtjen Investive të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitin 2022" me numër të prokurimit 205-22-3464-5-1-1, për Lot 1 dhe 2, iniciuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në cilësi të Autoritetit Kontraktues (AK) me 13.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen si të bazuara, ankesa e GOE "Pro&Co Group ShPK & Victoria Invest International ShPK" me seli në Graçanicë, e parashtruar në OSHP me 28.12.2022, numër protokolli 804/2022 dhe ankesa e GOE "Lika Trade ShPK dhe Lika Company ShPK" me seli në Deçan, e parashtruar në OSHP me 29.12.2022, numër protokolli 808/2022 për aktivitetin e prokurimit me titull "Për Mirëmbajtjen Investive të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitin 2022" me numër të prokurimit 205-22-3464-5-1-1, për Lot 1 dhe 2, kurse **Anulohet,** Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës i datës 13.12.2022, për aktivitetin e prokurimit të cituar si më parë dhe ky aktivitet i prokurimit kthehet ne **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi) në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të LPP.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, me ç 'rast ankuesit, me të dhëna si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij Vendimi, kanë të drejtë të ushtrojnë kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë /60 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 13.12.2022, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duke vepruar në cilësinë e AK, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Për Mirëmbajtjen Investive të Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për Vitin 2022" me numër të prokurimit 205-22-3464-5-1-1, sipas të cilit për kontratë janë rekomanduar: GOE "Bujar Shabani B.I; Via Egnatia ShPK dhe Bageri 1 ShPK" për Lot 1. GOE "RSM Company ShPK dhe Kosova Asfalt ShPK" për Lot 2. Dhe GOE "Rahovica Comerce &Linda" për Lot 3.

Me 19.12.2022, GOE "Pro&Co Group ShPK & Victoria Invest International ShPK" ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim, kurse me 20.12.2022 po ashtu dhe GOE "Lika Trade ShPK dhe Lika Company ShPK" me seli në Deçan ka parashtruar kërkesa për ri shqyrtim, të cilat janë refuzuar me Vendimin e AK të datës 13.12.2022.

Me 28.12.2022, GOE "Pro&Co Group shpk & Victoria Invest International shpk" ka parashtruar ankesë në OSHP kundër vendimit të cituar si më sipër të AK dhe po ndaj të njëjtit vendim ka ushtruar ankesë në OSHP me 19.12.2022, po ashtu dhe GOE "Lika Trade" shpk dhe "Lika Company" shpk.

Me rastin e shqyrtimit paraprak: Është konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP. Ankuesit po ashtu kanë ushtruar kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e tyre i referohen njëherësh dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar [Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve]. Meqë OSHP konsideron se ankuesit kanë statusin e palës me interes material, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.26, të nenit 4, të LPP dhe meqë ankesat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara, do të thotë se të njëjtat bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të Ligjit të cituar.

Bazuar në lartë cekurat, OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 dhe 114 të LPP, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. I njëjti me 27.12.2022 e ka dorëzuar raportin e ekspertizës me rekomandimet si në vijim:

- Të aprovohet si e bazuar ankesa e GOE "Pro&Co Group shpk & Victoria Invest International shpk" për Lot 1&2;
- Të aprovohet si e bazuar ankesa e GOE "Lika Trade shpk dhe Lika Company shpk" për Lot 1;
- Lënda të kthehet në Rivlerësim.

OSHP ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës (përmes postës elektronike) me c'rast AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa të dy ankuesit janë pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe rekomandimet të cilat ekspertiza e cituar i përmban.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër dhe ka konstatuar se: Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur në ketë aktivitet të prokurimit; Lloji i kontratës: punë, shërbim; Vlera e parashikuar e kontratës: Lot 1=1,121,950.00 €; Lot 2=1,519,800.00 €; Lot 3=954,960.00 €; Totali = 3,596,710.00 €. (vlera e përgjithshme e aktivitetit të prokurimit = 3,596,710.00 €).

Mirëpo bazuar në pretendimet ankimore në raport me natyrën e çështjes në rastin konkret dhe kriteret e publikuar sipas dosjes së tenderit në rastin konkret, Paneli e ka konvokuar seancën dëgjimore me palë (AK dhe OE) sikurse parashihet me paragrafin 2 të nenit 24 të Rregullores për punën e OSHP, duke e konsideruar ketë paraprakisht të nevojshme me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Paraprakisht Paneli konstatoi se nuk ka elemente për ekzistimin e konfliktit eventual të interesit, sikurse përkufizohet në kuptim të paragrafit 1.75, të neni 4, të LPP, lidhur me dispozitën e nenit 11 të Rregullores së cituar, kurse pohimet e palëve, shpjegimet e ekspertit dhe provat e administruara, janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance (radhitur sipas deklarimeve të palëve apo ekspertit), të cilat në ketë rast për nevojat e këtij vendimi prezantohen (shkurtimisht) sikurse vijon:

- Seanca dëgjimore -

Ankuesi për Lot 1, "Pro&Co Group shpk & Victoria Invest International shpk" ka pohuar se AK ka shkelur LPP respektivisht nenin 1,6,7,13,56 paragrafi 3,59 68 69 dhe 72 dhe po ashtu ka vepruar ne kundërshtim me RROUP nenin 26, 27, 28, 39 dhe 41, sepse (sipas ankuesit) ka rekomanduar për kontratë një OE të pa-përgjegjshëm, duke theksuar se Letra mbështetëse nga Banka nuk është lëshuar ne emër te Liderit por te njërit prej partnereve të GOE, gjë që nuk përmbush kriterin e kërkuar me Dosje te Tenderit (DT). Lidhur me ketë, sipas ekspertit shqyrtues është konstatuar se Letra, përkatësisht dokumenti i cituar është e lëshuar nga Banka ne emër te Kompanisë "Bageri 1 shpk" e cila sipas marrëveshjes nuk figuron si Lider i GOE për te konkurruar ne Lot 1. Sipas marrëveshjes së partneritetit mes tre/3 OE, si Lider i Grupit të OE është caktuar entiteti afarist me emrin tregtar "NPSH Bageri" andaj "Bageri 1 shpk" nuk është Lideri i caktuar GOE. Lidhur me ketë, Paneli konsideron se në kuptim të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (jo vetëm sipas këtij Ligji) secili entitet ka subjektivitet të veçantë juridik, në të kundërtën nuk mund të arrihet marrëveshje e partneritetit mes tyre, po ashtu edhe subjektiviteti i entitetit afarist dhe subjektiviteti i themeluesit, janë të ndara. Prandaj është jo kontestues fakti se, Letra e lëshuar nga Banka nuk është ne emër te Liderit te grupit NPSH Bageri, por të njërit prej partnereve te GOE d.t.th. Bageri 1. Shpk. Dhe meqë me DT, një kriter i tillë i atribuohet shprehimisht Liderit, d.t.th. se të drejta dhe detyrime të tilla janë ta pa-transferueshme tek subjektet tjerë (pavarësisht emrit të përafërt tregtar).

Në fakt, në bazë të kërkesës/specifikave ne DT është kërkuar: Pika 2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku (Lideri i grupit duhet te këtë minimum 60% te mbështetjes bankare). Mirëpo Paneli vëren po ashtu se në Letrën e lëshuar nga Banka, citohet kompania Kosova Asfalt shpk (një entitet tjetër afarist) e cila nuk i takon GOE konkurrues për këtë Lot 1, pavarësisht bankës e cila i konsideron kompani të ndërlidhura, sepse shprehja *kompani të ndërlidhura* nuk e absorbon subjektivitetin juridik të ndonjë entiteti tjetër. Paneli konsideron se në kontekstin e shpjegimeve si më sipër, citati: "Kompanitë e ndërlidhura me "Bageri 1 shpk" (d.t.th. Bujar Shabani B.I dhe Kosova Asfalt shpk) bije ndesh me deklaratën nen betim të OE Kosova Asfalt shpk se "nuk janë duke marrë pjesë individualisht ose në ndonjë grup OE në të njëjtën procedure te prokurimit" (v.j. nënkupto Kosova Asfalt shpk dhe Bageri 1 shpk). Në përgjigjen e OE "Bageri" shpk drejtuar AK me 15.11.2022 thuhet, cituar: "Të gjitha këto kompani janë në pronësinë tonë dhe çdo kredi, limit apo garancion janë bashkë huamarrës etj." Mirëpo ky fakt është jo relevant në raport me kërkesat eksplicite të DT dhe statusin juridik të secilit entitet.

Në kontekstin e këtyre shpjegimeve po ashtu duhet theksuar se në deklarimin e Bankës është përshirë dhe OE "Kosova Asfalt shpk" që nuk ka të bëjë me këtë GOE dhe me këtë LOT por me një Lot tjetër të DT. Në fakt, Eksperti thekson se nga shkresat e lëndës Kosova Asfalt shpk është rekomanduar për kontrate ne Lotin 2, në kuadrin e të njëjtit aktivitet të prokurimit, dhe sipas tij kjo bije ne kundërshtim me dispozitën e nenit 18.9 te Rregullores për Prokurimin Publik, sipas së cilës: "*...nuk mund të mbështeten* në të njëjtat kapacitete të OE tjerë pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit që është ndarë në Lote". Bazuar në shpjegimet e ekspertit shqyrtues dhe në vlerësimin e tij të pavarur, Paneli konsideron se pohimet ankimore të cituara si më sipër, janë të bazuara.

Po ashtu GOE nuk përmbush kriterin për udhëheqësin e punishtes sepse nuk ka referencë konform kërkesës për udhëheqësin e punishtes. Kurse, sa i përket pretendimit ankimor për diplomën e gjeodetit që është kërkuar të jetë e përkthyer në gjuhën zyrtare sipas dosjes së tenderit, të parashtruar nga OE ankues, paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues dhe dëshmisë së diplomës së përkthyer në shkresat e lëndës, konstaton se e njëjta është përkthyer pas afatit te hapjes se tenderit. Dokumenti është i përkthyer ne Prizren me date 14.10.2022 kurse hapja e procedurës tenderuese është bere me 06.06.2022 ora 14:00.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e AK po ashtu edhe për Lot 2, duke pohuar se AK ka shpërblyer për kontratë GOE RSM Company &Kosova Asphalt, i cili nuk e përmbush kriterin lidhur me Listën e mjeteve siç është kërkuar shprehimisht ne DT, tek dëshmia 6, cituar: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, kurse paisjet tjera duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, dud, etj.). Në listën e pajisjeve sipas DT, parashihet po ashtu dhe pajisja me nr. 4. Cisterne (tanket uji). Sipas ankuesit, pajisja e cila është ofruar nga OE i rekomanduar nuk është Cisternë, por kamion në të cilin OE i rekomanduar për kontratë e ka të ngarkuar një rezervar të ujit, gjë që nuk është konform kërkesës së FDT.

Ankuesi për Lot 2 ("Lika Trade" shpk dhe "Lika Company" shpk) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK dhe ka pohuar (sikurse ankuesi paraprak) se AK ka shkelur dispozitat e neneve 1,7, 59, 60,64 dhe 69 të LPP sepse ka rekomanduar për kontratë GOE i cili (sipas ankuesit) është i papërgjegjshëm përkitazi e kapacitetin teknik dhe profesional, sepse i njëjti nuk i përmbush kriteret e cituar sikurse është parashikuar shprehimisht me DT, posaçërisht lidhur me pajisjen Cisternë (tanket) e ujit. Në fakt, OE i rekomanduar për Lot 2, ka ofruar Librezën e regjistrimit me numër 01-175-LH, sipas së cilës konstatohet se ky mjet nuk është Cisternë dhe nuk është i regjistruar si i tillë, por është një kamion i improvizuar nga OE i rekomanduar, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e cituara dhe kriteret e publikuar në DT.

Krahas shpjegimeve (në seancë) të ekspertit dhe pretendimeve të Ankuesve"Pro&Co Group shpk & Victoria Invest International shpk dhe"Lika Trade" shpk dhe "Lika Company" shpk për LOT 2 (*përshkruar në detaje në ankesat me Nr. protokolli 804-807/22*)[1] Paneli vëren se në DT është kërkuar vërtetë makineria me emërtimin Cisterna (tanket) e ujit, ndërsa sipas Librezës është jo kontestuese se bëhet fjalë për Kamion me 2 dyer me numër Regjistrimi 01-175- LH, andaj OE i rekomanduar për kontrate, nuk e ka plotësuar ketë kriter.

Në vijim ankuesi Pro&Co Group shpk & Victoria Invest International shpk, po ashtu edhe ankuesi "Lika Trade" shpk dhe "Lika Company" për LOT 2, kanë pohuar se OE i rekomanduar për kontratë ka përdorur dhe ka bërë kontrata ne emër te kompanisë tashme te shuar RS&M me numër Biznesit 70298276, kurse po te njëjtat dokumente janë vulosur me vulën e firmës RSM Company shpk me nr. Biznesi 70658046. Pretendimet në rastin konkret sipas eksperti shqyrtues janë vlerësuar të qëndrueshme bazuar në një prej kontratave e cila është bere me firmën me emër RS&M me numër biznesit 70298276, kurse është vulosur me vulën e RSM Company shpk. Mirëpo Paneli gjatë administrimit të provave mori në konsideratë Njoftimin e lëshuar nga ARBK, me 11.01.2012, sipas të cilit konstatohet se biznesi "Road Sings & Marketing Dega në Kosovë" me numër 70298276, i është bashkuar biznesit "RSM Company SHPK, me numër 706580046, prandaj fakti se vulat e përdorura nuk janë kompakte në çdo dokument nuk e mohon kontinuitetin e të njëjtit subjekt juridik dhe nga kjo pikëpamje Paneli nuk e mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues analizoj edhe pretendimin për parregullsitë në piken e udhëheqësit te punishtes apo inxhinierit sipas OE ankues, ku vlerëson se ne CV-ne e tij përpos përvojës dhe referencave, shihet se ka mos përputhshmëri mbi shkollimin dhe përfundimin e fakultetit, ku ne CV deklarohet qe ka përfunduar studimet nga 1991-1996 kurse ne diplomën e ofruar shihet qe provimet e këtij drejtimi i ka te përfunduara ne vitin 2009.

Tutje eksperti shqyrtues ka konsideruar se pretendimet e OE ankues "Lika Trade shpk" per Lot 2, janë te bazuara edhe për sa i përket faktit se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka arritur të ofroj përgjigje konkrete, por ka dërguar disa linqe ne internet te cilat nuk përkojnë me kërkesat dhe specifikimet e kërkuara teknike dhe makinerisë se kërkuar me DT dhe përveç kësaj

[1] https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search

katalogët nga interneti nuk e vërtetojnë autorësinë apo pronësinë e makinerive ne rastin konkret. Në fakt, OE i rekomanduar ka dërguar disa foto te cilindrave, gjë qe nuk kanë ndonjë domethënie me pronësinë dhe pajisjet e parapara me DT.

Më tej, ankuesi OE "Lika Trade shpk" ka pohuar se GOE i rekomanduar për kontrate për Lot 2, nuk ka paraqitur Plan te menaxhimit te trafikut te detajuar, kurse gjatë administrimit të provave në seancë, Paneli vërejti se Plani i paraqitur nga OE i rekomanduar për kontrate dukshëm i mangët ne krahasim me atë të ankuesit sepse nuk ka titull, emër te projektit, nuk ka numër te aktivitetit të prokurimit për të cilin dedikohet apo date, të cilat një dokumenti tillë do te duhej ti përmbante sepse bëhet fjalë për punime ne rrugët Nacionale dhe Rajonale. Në fakt, në dokumentin e ankuesit figurojnë te gjitha këto te dhëna te detajuara përfshirë dhe emrat e eksperteve përkatës.

Paneli konsideron se pretendimet tjera nuk janë konsideruar me ndikim qenësor, përderisa shqyrtimi i pretendimeve të mesi sipërme janë të mjaftueshme për të vendosur në mënyrë meritore lidhur me çështjen në rastin konkret, sikurse kërkohet me dispozitat e nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

- Përfundim-

Paneli shqyrtues pasi analizoj të gjitha pretendimet ankimore e duke u mbështetur po ashtu edhe ne shpjegimet e ekspertit shqyrtues, konsideron se AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave siç kërkohet me nenin 59 të LPP, kjo për faktin se GOE të rekomanduar nuk i ka plotësuar kërkesat e DT ashtu siç i ka kërkuar AK për të cilat nuk ka kërkuar sqarime të duhura, kurse ato të cilat janë këmbyer nuk kanë janë konform kërkesave të LPP dhe në raport me rëndësinë e aktivitetit të prokurimit. Prandaj bazuar në të lartcekurat Paneli konsideron se rekomandimet e ekspertit janë të pranueshme dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesën e GOE "Pro&Co Group shpk & Victoria Invest International shpk"- me seli në Graçanicë dhe ankesën e parashtruar nga GOE "Lika Trade shpk dhe Lika Company shpk", me seli në Deçan, ti aprovojë si të bazuara. Kështu që rrjedhimisht dy GOE të rekomanduara për kontratë për dy lotet e referuara dhe atë Lot 1 dhe Lot 2, nga paneli shqyrtues klasifikohen si të papërgjegjshme, andaj gjatë rivlerësimit AK obligohet që ti eliminojë nga ky aktivitet prokurimi.

Kurse, vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK Ministria e Infrastrukturës.
- OE-ve ankuese.
- Arhivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb- faqe të OSHP